



**UBT  
UNIVERSITETI BUJQËSOR I  
TIRANËS**

Nr. 578 Prot  
Tiranë , më datë 08/02/2025



**Shkolla e Mesme  
Profesionale  
Mihal Shahini**

**SHKOLLA PROFESIONALE  
“MIHAL SHAHINI “  
CËRRIK**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot  
Cërrik , më datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

Në zbatim të Ligjit Nr15/2017, datë 16/2/2017, “ Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimit Nr 759, datë 30/09/2024, “ Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së Njesisë së Zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit” Neni 7 , lidhet kjo marrëveshje si më poshtë:

**UBT (Universiteti bujqësor i Tiranës** me adresë:Rruga: “Paisi Vodica”, Tiranë, 1025  
përfaqësuar nga Prof.Dr. **Fatbardh Sallaku** , Rektor  
dhe

**Shkolla e mesme profesionale “ Mihal Shahini”** me adresë: Rruga “Gjimnazistët “ Nr 2 ,  
Cerrik , 3007, përfaqësuar nga **Znj. Erina Disho**, drejtor ;  
më poshtë të quajtura “palë”, të nisur nga dëshira për të vendosur lidhje më të mira  
bashkëpunimi institucional me interes reciprok si dhe me qëllim disiplinimin e shkëmbimit dhe  
koordinimit të veprimtarive mësimore, kërkimore, shkencore dhe zhvillimore ranë dakord për sa vijon:

**Neni 1**

Palët, do të bashkëpunojnë në shkëmbimin e eksperiencës së stafit pedagogjik dhe nxënësve të shkollës, nëpërmjet organizimit të seminareve trajnuese, leksionevë të hapura, orëve të praktikës etj.

**Neni 2**

Palët, sipas kushteve dhe mundësive, do të organizojnë aktivitete të përbashkëta vjetore apo periodike me interes të përbashkët të zhvillimit të institucionit dhe nxënësve.

**Neni 3**

Palët do të informojnë njëra-tjetrën për organizimin e veprimtarive shkencore dhe zhvillimit nga ana e tyre ose në bashkëpunim me institucione homologe, vendase ose të huaja dhe do të inkurajojnë pjesëmarrjen e stafëve përkatëse të tyre në këto veprimtari.

#### **Neni 4**

Të dyja palët, sipas kushteve dhe mundësive do të bëjnë shkëmbimin e ambjenteve laboratorike dhe didaktike për studentët/nxënësit dhe stafet akademike/pedagogjike.

#### **Neni 5**

Palët, sipas kushteve dhe mundësive, do të shkëmbejnë lektorë për dhënie leksionesh në disiplina që do ti gjykojnë me interes të përbashkët, duke respektuar mundësitë dhe aktet e brëndshme normative të tyre.

#### **Neni 6**

Palët lidhin partneritet për zhvillimin e projekteve zhvillimore të përbashkëta për t'iu përgjigjur në mënyrë më efektive nevojave të tregut të punës dhe kërkesave individuale të nxënësve.

#### **Neni 7**

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi duke filluar nga data e nënshkrimit, e në vazhdim.

#### **Neni 8**

Kjo marrëveshje mund të zgjidhet në mënyrë të njëanshme nga secila prej palëve nëpërmjet një njoftimi zyrtar, me shkrim.

Nënshkruar më \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_ në dy kopje origjinale në gjuhën Shqipe.

#### **Palët në marrëveshje:**

Për

Universitetin Bujqësor të Tiranës

Rektori

Prof. Dr. Z. Fatbardh Sallaku



Për

Shkollën e mesme profesionale 'Mihal Shahini' "

Drejtori

Zj. Erina DISHO